




REPUBLIKA E KOSOVËS
REPUBLIKA KOSOVA/REPUBLIC OF KOSOVO



KOMUNA SHTIME/OPSTINA STIMLJE/MUNICIPALITY SHTIME

Zyra e kryetarit/Kancelarija predsednika/Mayor's office

Data/Datum/Date:	15.09.2022
Nr/Br/No:	Zrt. 02/534
Përmes/Preko/Through:	Zyrës së Kryetarit, z. Qemajl Aliu
Nga/Od/From:	Zyra e Informimit
Lënda/Predmet/ject:	Debat publik me qytetarë

Duke u bazuar në vendimin e Kuvendit të datës 31.05.2022, më 14 shtator, në sallën e Kuvendit Komunal të Shtimes, u mbajt dëgjimi publik me qytetarët e komunës, lagjeve dhe fshatrave, lidhur me draft – buxhetin komunal 2023-2025, filloi në ora 14:20 ku morën pjesë 21 pjesëmarrës (shih listën).

PROCESVERBAL

Kryetari i komunës së Shtimes, Z.Qemajl Aliu – Faleminderit të gjithë qytetarëve të komunës së Shtimes që jeni këtu dhe të gjithë asamblistëve për prezencën dhe përgjigjen ndaj kësaj thirrje. Qëllimi i këtij takimi është hartimi i buxhetit komunal 2023-2025 dhe do të bisedojmë për nevojat dhe kërkesat që kenë secili prej jush për vendbanimi që vini, mund të diskutojmë për propozimet e juaja. E shpalli të hapur debatin. Këtu jam së bashku me nënkryetarin, shefin e asamblistëve, zyrtarin kryesor të financave dhe drejtorët përkatës. Faleminderit edhe njëherë, fjala ju takon juve, presim ndonjë këshillë, propozim, kërkesë, debati është i hapur.

Zyrtari kryesor i Financave, z.Bujar Ferati – Shkurtimisht do të prezantoj planin buxhetor komunal për 2023-2025, njoftimet kanë qenë të hapura dhe publike përmes mjeteve të informimit. Buxheti i ri për komunën e Shtimes është 8,756,000.040, komplet buxhetin e komunës së Shtimes për vitin 2023. Në buxhet përfshihet edhe granti i përgjithshëm specifik për arsimin dhe shëndetësisë.

Dallimi prej vitit të kaluar në këtë vit është në vlerën 1,052,011.00. Është rritur buxheti nga viti 2022 në vitin 2023.

Ai prezantoi veç e veç ndarjen e buxhetit për secilën kategori dhe drejtori.

Znj.Adelina Beqaj, këshilltare e Kuvendit – Sa i përket këtij dëgjimi publik kisha kërkuar nga zyrtari financiar që t'i elaboroi pak investimet kapitale dhe projektet më madhore dhe cilat janë specifikat e tyre?

Z.Bujar Ferati, zyrtar financiar : Këtu ka projekte me numra, projektet të cilat janë duke u zbatuar janë 22 që kanë mundësi me qenë projekte që do të vazhdojnë edhe në vitin 2023, pra janë projekte dyvjeçare. Mirëpo kemi projekte të reja të cilat kanë rrjedhë shumica prej kërkesave të qytetarëve, kërkesave të zyrës së kryetarit.

Ferati elaboroi në tërësi projektet e planifikimit urban si dhe drejtorive të tjera që kanë kapitale duke cekur shumën e ndarë për secilin prej tyre.

Z.Ramadan Krasniqi, qytetar – Cilat janë projektet për fshatin Dugë? Kërkesa tjerë e imja është asfaltimi i 400m rrugës për tek varrezat dhe shtrimi i rrugës me zhavorr për tek Maja e Bretencit, që është një vend turistik.

Z.Qemajl Aliu, kryetar – Faleminderit për angazhimin dhe kohën që ke ndarë. Ky buxhet do të jetë buxhet i qytetarëve, i nevojave dhe prioriteteve të qytetarëve. Unë në seancën e ardhshme në Kuvendin Komunal do ta prezantojmë një buxhet që bazën e ka në kërkesa në nevoja të qytetarëve. Nuk është se fshati Dugë është jashtë vëmendjes sonë, natyra dhe vendbanimi është i jashtëzakonshëm. Në të ardhshmen, në kuadër të zhvillimit malor do ta kemi një plan për shumicën e këtyre fshatrave, përfshirë edhe Dugën. Këto kërkesa na ndihmojnë dhe shpresoj se bashkë me drejtorët dhe ekipin do të merremi me këtë kërkesë legjitime që ta përfshijmë në buxhetin 2023. Siç e cekëm, buxheti është rritur mbi 1 milionë, i cili do të shpërndahet, përveç investimeve kapitale, edhe në subvencione që janë të rritura 100%, në kulturë, shëndetësi, bujqësi, arsim etj.

Z.Halil Halili, qytetar – Çfarë po ndodh rreth projektit “Shtabi i UÇK”-së, ku është si proces?

Po ashtu, rruga që është rregulluar mungojnë anësoret dhe reshjet e shiut mund ta dëmtojnë asfaltimin, a do të rregullohen?

Z.Qemajl Aliu, kryetar – Faleminderit për pyetjen dhe prezencën. Rruga është në fazën përfundimtare. Për ndërtimin e Shtabit të UÇK-së jemi angazhuar prej se kemi ardhur në qeverisje dhe kemi pasur takime me drejtorin e Agjencisë së Memorialeve. Në buxhetin 2023 primar është të fillohet ndërtimi i Shtabit. Kompleksi i familjes Asllani është në përfundim. Projekti kryesor i Agjencisë së Memorialeve do të jetë ndërtimi i Shtabit. Kurse për rrugën në Rancë është në proces gjyqësor.

Z.Grejtalb Emini, drejtor – Lidhur me ndërtimin e anësoreve në këtë rrugë – 50,000.00 euro kanë qenë të destinuara për këtë rrugë, kurse në vitin 2024 planifikohet ndërtimi i tyre.

Znj. Sanie Sadiku, këshilltare komunale – Kërkesa ime është ndërtimi i trotuarit në rrugën “Ahmet Shtimja” pasi mungesa e tij rrezikon lëvizjen e qytetarëve.

Z. Grejtalb Emini, drejtor – Ndërtimi i rrugës do të përfundojë gjatë dy muajve kurse për trotuarin do ta shqyrtojmë ta përfshijmë në buxhetin e ri komunal.

Z.Reshat Mujota, këshilltar komunal – Më interesoj të çështja e investimeve kapitale, në asnjë vend nuk u përmend edhe interesimi drejt ujësjellësit për mirëmbajtje, për investime të reja në ujësjellës, kur presim që na me pas ujë. Qytetari ka gjënë më kryesore ujin, në buxhet dhe në draft që e kemi pasur më herët nuk ka qenë i përfshirë, kisha pas dëshirë a ka mundësi dhe a ka hapësirë që mundemi me nda një fond në këtë buxhet dhe në kuadër të investimeve të reja që të kemi ujë?

Z.Qemajl Aliu, kryetar – Faleminderit Reshat për pyetje. Realisht uji i pijshëm në komunën tonë është problem e kemi evidentuar e kemi cek. Me të ardhur në muajt e parë, si kryetar i komunës së Shtimes takimet e para kemi pasur me z.Sokol Xhafa të KRU Prishtinës, duke ditur gjendjen në terren. Megjithatë ndërhyrje të shpejta dhe të menjëhershme s'kemi pasur mundësi të bëjmë. Megjithatë është një situatë e trashëguar. Kjo punë do plan, procedura, ndarje të fondeve e buxhetit dhe pas disa takimeve me KRU Prishtinën jemi marrë vesh për një projekt që ka qenë i hartuar për një ndërhyrje në sistemin e ujësjellësit dhe është plan që koston e ka 315,000.00 euro do të shkohet mbi fshatin Rashincë dhe Gllavincë ku ekspertët e KRU-Prishtinës, degës në Shtime mendojnë që rezervat ujore për furnizim të qytetarëve përmes kësaj ndërhyrje mund të sigurohen minimumi prej 5-10 vitet e ardhshme. Kemi gjetur edhe një donator që është Katari i cili ka shprehur gatishmërinë që në shumën 60% të bëhet pjesë e këtij projekti dhe bashkërisht me KRU Prishtinën e kemi ndarë 20% rreth 64,000.00 euro. Projekti është i gatshëm dhe ne mendojmë që në prill 2023 do të fillohet projekti dhe shpresojmë që vera e ardhshme të na gjej me kapacitete për furnizim me ujë të pijshëm.

Në planin afatgjatë kemi biseduar edhe me ministrin z.Liburn Aliu për zgjedhjen e ujit është Diga e Firajës që sot është vendim qeveritar që të filloj puna dhe pritet që brenda 3-4 vjet të përfundoj dhe një tub i veçantë të vijë e të përfundoj diku te Pishat dhe komuna e Shtimes do ta zgjidh përfundimisht çështjen e ujit të pijshëm.


Znj. Adelina Beqaj, këshilltare komunale – Fshati Karaqicë dhe Llanisht duket se janë të anashkaluara në investimet kapitale. Po ashtu desha të pyes për rregullimin e hapësirës të Shtëpisë së Kulturës dhe a përfshihet edhe objekti i saj?

Z.Qemajl Aliu, kryetar – Shtëpia e Kulturës është vet tmërri i komunës së Shtimes se si është lënë. Ndonëse më 2017 është investuar së fundmi në të prapë i ngjan një objekti të pasluftës, Ne e kishim vizitën e ministrit të Kulturës dhe zotimet e tij për 2023 ishin investimet në Qendrën Rinore. Kemi në plan përmes konkursit të ipet një bar ku përmes të hyrave që do të ketë lokali do të përkujdesen për pastërtinë.

Z.Driton Latifi, qytetar – A do të ndërtohet çerdhja në fshatin Godanc dhe a do të bëhet ndërtimi i unazës në vitin 2023?

Z.Qemajl Aliu, kryetar – Një nga investimet që tashmë është memorandum i nënshkruar është ndërtimi i Unazës që e lidh rrugën 14 dhjetori me rrugën për Lipjan. Zotimi i atyre parave ka pasur të bëhet në rishqyrtimin e buxhetit që ka pasur në ndodh në shtator nga Qeveria dhe ky rishqyrtim nuk ka ndodhur dhe besoj se alokimi i fondeve do të ndodh në buxhetin 2023. Për çerdhe dje isha, ka disa ditë që i kemi dorëzuar projektet e detajuara të fshatit Muzeqinë dhe të një qerdhje që ka qenë e destinuar nga Parlamenti i Kosovës për në qytetin e Shtimes, por ne e kemi dislokuar në Godanc pasi janë dy çerdhe edhe pse vetëm njëra është funksionale, tjetrën llogarisim me u funksionalizu pas janarit 2023, për këtë është dashur të kërkojmë numër të punëtorëve shtesë dhe Ministria e Financave na ka lejuar këtë.

Z.Redon Nuredini, qytetar – Pyetje lidhur me asfaltimin e rrugës 17 shkurti në fshatin Godanc që lidhet me Gjurkoc dhe për mundësinë e rregullimit të kanalizimit dhe trotuareve në këtë pjesë. Po ashtu desha të pyes se si mund komuna të shtyjë qytetarët të regjistrohen në sistemin e pagesave të mbeturinave, pasi ata dikund e gjuajnë bërllokun?



Z.Qemajl Aliu, kryetar – 17 shkurti në fshatin Gjurkoc është rrugë që bashkë me Unazën e Qytetit do të investohet dhe pritet të bëhet zotimi dhe të hapet tenderimi dhe këto dy rrugë që do bëhen brenda dy vitesh. Përmes grantit qeveritar janë të ndarë 20,000.00 dhe për tre vitet e ardhshme do të investohen diku rreth 130,000.00 euro vetëm kanalizim në këtë pjesë.

Sa i përket mbeturinave, e dimë që në gjithë territorin e Kosovës ka probleme. Jemi munduar me dhënë kontributin tonë në ndihmë të kompanisë rajonale "Pastërtia", nuk jemi të kënaqur duhet të ndodh një risistemim atje, një menaxhim më i mirë i kompanisë. Megjithatë ne qasje direkte nuk kemi, i kemi përfituar tre kamionë që kanë dhënë direkt efekt në mbledhjen e mbeturinave por kjo është diçka minimale dhe ne do të punojmë çdo ditë që çështja e mbeturinave të zgjidhet.

Z.Redon Nuredini, qytetar – Cili është plani i veprimit pas rritjes së subvencioneve, si do ndahen?

Z.Bujar Ferati, zyrtar kryesor financiar – Subvencionet janë transparente të gjitha, tek bujqësia për vitin 2022 shuma ka qenë 34,766.00 është rritur për 20,000.00 euro, pra 54,766.00.

Debati përfundoi në ora 15:55.

Procesmbajtësja,

Anita Kurti